



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**VENDIM**  
**Nr. 132, datë 06.04.2020**

**PËR**  
**CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË**  
**VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË**  
**FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 e 89 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionin dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

**VENDOSI:**

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DIBËR**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Rexhep Karaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, çështjen gjyqësore në ngarkim të të pandehurit: {...}; i akuzuar për kryerjen e veprave penale: “Vrasje me paramendim”, mbetur në tentativë, e kryer në bashkëpunim, dhe “Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë, dhe i municioneve”, parashikuar nga nenet 78/1-22 e 25 dhe 278/1 të Kodit Penal”.

2. Gjyqtarii Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Murat Lleshi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, çështjen gjyqësore në ngarkim të të pandehurit: {...}; i akuzuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 79 pika “ë” dhe 278/1 të Kodit Penal.

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KURBIN**

1. Gjyqtarii Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Ahmet Metaliaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, çështjen gjyqësore në ngarkim të të pandehurit: {...}; i akuzuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 283/1, 278/1, 277 e 84 të kodit Penal.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Arben Micko, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, çështjen gjyqësore çështjen gjyqësore në ngarkim të të pandehurit: G{...}; i akuzuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 79/ë e 22 dhe 278/1 të Kodit Penal.

### **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KAVAJË**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, EdaKaja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen gjyqësore në ngarkim të të pandehurëve: {...}{...}; të akuzuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 78/1, 280 dhe 300 të Kodit Penal.

### **GJYKATA E APELIT GJIROKASTËR**

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, Petrit Aliaj (Relator), Skënder Damini dhe Margarita Buhali caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen gjyqësore në ngarkim të të pandehurit: {...}; i akuzuar për kryerjen e veprës penale: “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**